



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*MINISTRIA E FINANCAVE/MINISTARSTVO ZA FINANSIJE*  
*MINISTRY OF FINANCE*

KB FR Kosovo Board on Standards for Financial Reporting  
 BK RF Bordi Kosovar mbi Standardet per Raportim Financiar  
 KB FI Kosovski Bord za Standarde Finansijskog Izvestavanja

**SKK 17**  
**Provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente**

**Qëllimi**

Qëllim i këtij standardi është të sigurohet se kriteret e duhura të njohjes si dhe bazat e matjes zbatohen për provizionet, detyrimet e kontingjente dhe pasuritë e kontingjente dhe që informata të mjaftueshme të jenë shpalosur në shënimet e pasqyrave financiare për t'u mundësuar përdoruesve që ta kuptojnë natyrën, kohëzgjatjen dhe shumën e tyre.

**Fushëveprimi**

1. Ky standard duhet të zbatohet nga të gjitha ndërmarrjet gjatë llogaritjes së provizioneve, detyrimeve kontingjente dhe pasurive kontingjente, përveç:
  - a) atyre që rezultojnë nga instrumentet financiare e që regjistrohen në vlerën fer;
  - b) atyre që krijohen nga ndërmarrjet e sigurimit me kontrata për të siguruarit; dhe
  - c) atyre që mbulohen nga standardet e tjera të kontabilitetit të Kosovës.

2. Ky standard zbatohet për instrumentet financiare që nuk regjistrohen në vlerën fer.
3. Kontratat e zbatueshme janë kontratat në të cilat asnjëra palë nuk e ka kryer ndonjë nga obligimet e saj ose që të dy palët, pjesërisht, i kanë kryer obligimet e tyre deri në një nivel të barabartë. Ky standard nuk përdoret për kontratat e zbatueshme po qe se ato nuk janë të vështira. Kontrata e vështirë është ajo kontratë, në të cilën ndeshemi me shpenzimet e pashmangshme të obligimeve që sipas kontratës i tejkalojnë përfitimet ekonomike të pritura për t'u pranuar prej saj.
4. Ky standard zbatohet për provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente të ndërmarrjeve të sigurimit, të ndryshme nga ato që krijohen nga kontratat me të siguruarit.
5. Kur ndonjë standard tjetër i kontabilitetit të Kosovës ka të bëjë me llojin specifik të provizionit, detyrimit kontingjent dhe pasurisë kontingjente, ndërmarrja e zbaton atë standard në vend të këtij standardi. Për shembull, lloje të caktuara të provizioneve, po ashtu, u adresohen standardeve për:
  - (a) kontratat e ndërtimit (shih SKK 16 “Kontratat e ndërtimit”)
  - (b) tatimet mbi fitim (shih SKK 12 “Tatimet mbi fitim”)
  - (c) lizingët (shih SKK 13 “Lizingët”). Sidoqoftë, pasi që SKK 13 nuk përmban kërkesa specifike që merren me lizingët operues që bëhen të vështirë, në këto raste zbatohet ky standard.
6. Ky standard i provizionet përkufizon si detyrime të kohëzgjatjeve dhe të shumave të pasigurta. Shprehja “provizion”, po ashtu, përdoret në kontekst të zërave si zhvlerësimi, dëmtimi i pasurisë dhe borxhi i dyshimt: këto janë korrigjimet për shumat e regjistruara të pasurive dhe nuk adresohen në këtë standard.
7. Standardet e tjera të kontabilitetit të Kosovës specifikojnë nëse të dalat trajtohen si pasuri apo si shpenzime. Këto çështje nuk i adresohen këtij standardi. Rrjedhimisht, ky standard as nuk e ndalon e as nuk e kërkon kapitalizimin e kostove të njohura kur provizioni të jetë bërë.

### **Përkufizimet**

8. Termat vijim përdoren në këtë standard me këto kuptime të caktuara:

**Provizioni** është obligim i shumës dhe kohëzgjatjes së pasigurtë.

**Detyrimi** është obligim i pranishëm i ndërmarrjes që krijohet nga ngjarjet në të kaluarën, përcaktimi përfundimtar i të cilit pritet që të rezultojë me një rrjedhë dalëse të burimeve prej ndërmarrjes, duke i trupëzuar përfitimet ekonomike.

**Ngjarja oblique** është ngjarja që krijon obligim ligjor apo konstruktiv që rezulton në atë që një ndërmarrje të mos ketë alternativë reale për ta përcaktuar përfundimisht atë obligim.

**Obligim ligjor** është obligimi që rrjedh nga:

- (a) kontrata (nëpërmjet kushteve të saj eksplicite dhe implicite);
- (b) legjislacioni; ose
- (c) veprime të tjera të ligjit.

**Obligimi konstruktiv** është obligimi që rrjedh nga veprimet e ndërmarrjes ku:

- (a) nga një model i themeluar i praktikës të së kaluarës, politikave të publikuara ose pasqyrës kurente të mjaftueshme specifike, ndërmarrja u ka treguar palëve të tjera se ajo do t'i pranojë përgjegjësitë e caktuara; dhe
- (b) si rezultat, ndërmarrja ka krijuar pritje të vlefshme në anën e atyre palëve se ajo do t'i shkarkojë këto përgjegjësi

**Detyrimi kontingjent** është:

- (a) obligimi i mundshëm që rrjedh nga ngjarjet e të kaluarës dhe ekzistimi i të cilit do të vërtetohej vetëm nga ndodhja ose mosndodhja e një ose më tepër ngjarjeve të pasigurta në të ardhmen që nuk janë tërësisht përbrenda kontrollit të ndërmarrjes; ose
- (b) obligimi i pranishëm që krijohet nga ngjarjet e së kaluarës, por nuk është njohur, sepse:
  - (i) nuk është e mundshme se një rrjedhë dalëse e burimeve të trupëzuara në përfitimet ekonomike do të kërkohet ta përcaktojë përfundimisht obligimin; ose

- (ii) shuma e obligimit nuk mund të matet me besueshmëri të mjaftueshme.

**Pasuria kontingjente** është pasuria e mundshme që rrjedh nga ngjarjet e së kaluarës dhe ekzistenca e së cilës do të vërtetohet vetëm nga ndodhja ose mosndodhja e një ose më tepër ngjarjeve të pasigurta në të ardhmen që nuk është në tërësi përbrenda kontrollit të ndërmarrjes.

**Kontrata e vështirë** është kontrata në të cilën kostot e pashmangshme të plotësimit të obligimeve sipas kontratës tejkalojnë përfitimet ekonomike të pritura për t'u pranuar sipas saj.

### **Provizionet dhe detyrimet e tjera**

9. Provizionet mund të dallohen nga obligimet e tilla, siç janë të pagueshmet e tregtisë dhe detyrimet akruale, sepse ekziston pasiguri rreth kohëzgjatjes ose shumës së të dalave që kërkohen për përcaktim përfundimtar. Në të kundërtën:
- (a) obligimet tregëtare janë obligimet për t'u paguar për mallra ose shërbime që janë pranuar ose furnizuar dhe që janë faturuar ose pajtuar formalisht me furnizuesin dhe
  - (b) akrualet janë detyrimet për t'i paguar mallrat ose shërbimet që janë pranuar ose furnizuar, por që nuk janë paguar, faturuar ose pajtuar formalisht me furnizuesin, duke përfshirë shumat ndaj punëtorve (për shembull, shumat lidhur me rrogat e mbledhura). Meqë ndonjëherë është e nevojshme që të vlerësohet shuma ose kohëzgjatja e akrualeve, pasiguria në përgjithësi është shumë më e vogël se për provizione.

Akrualet shpesh raportohen si pjesë e tregtisë dhe e të pagueshmeve të tjera, ndonëse provizionet raportohen ndaras në pasqyrat financiare.

### **Marrëdhënia ndërmjet provizioneve dhe detyrimeve kontingjente**

10. Në kuptim të përgjithshëm, të gjitha provizionet janë kontingjente, sepse ato janë të pasigurta sa i përket kohëzgjatjes ose shumës. Sidoqoftë, brenda këtij standardi shprehja “kontingjente” përdoret për detyrimet dhe pasuritë që nuk njihen, sepse ekzistimi i tyre do të vërtetohet vetëm nga ndodhja ose mosndodhja e një ose më tepër ngjarjeve të pasigurta në të ardhmen që nuk janë në tërësi përbrenda kontrollit të ndërmarrjes. Në vazhdim, shprehja “detyrimi kontingjent” përdoret për detyrimet që nuk plotësojnë kriteret e njohjes.

11. Ky standard bën dallimin midis:
- (a) provizioneve - që njihen si detyrime (duke supozuar se mund të bëhet një vlerësim i besueshëm), sepse ato janë detyrime të pranishme dhe është e mundshme (më shumë po se sa jo) që një rrjedhë dalëse e burimeve të trupëzuara në përfitimet ekonomike do të kërkohet për t'i përcaktuar përfundimisht obligimet; dhe
  - (b) detyrimet kontingjente - që nuk njihen si obligime, sepse ato janë ose:
    - (i) obligime të mundshme, për të cilat duhet të vërtetohet nëse ndërmarrja ka ndonjë obligim të pranishëm që mund të dërgojë drejt një rrjedhë dalëse të burimeve të trupëzuara në përfitimet ekonomike; ose
    - (ii) obligime të pranishme që nuk i plotësojnë kriteret e njohjes në këtë standard (ose sepse nuk është e mundshme që një rrjedhë dalëse e burimeve të trupëzuara në përfitimet ekonomike do të kërkohet për ta përcaktuar përfundimisht obligimin, ose një vlerësim i besueshëm e i mjaftueshëm i shumës së obligimit nuk mund të bëhet).

## **Njohja**

### **Provizionet**

12. Provizionit duhet të njihet kur:
- (a) ndërmarrja ka obligim të pranishëm (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjes nga e kaluara;
  - (b) është e mundshme se një rrjedhë dalëse e burimeve të trupëzuara në përfitimet ekonomike do të kërkohet për ta përcaktuar përfundimisht obligimin; dhe
  - (c) një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për shumën e obligimit. Nëse nuk plotësohen këto kushte, nuk do të njihet asnjë provizion.

### **Obligimi i pranishëm**

13. Në raste të rralla nuk është e qartë nëse ekziston ndonjë obligim i pranishëm. Në këso raste, mendohet se ngjarja nga e kaluara i jep një rritje obligimit të pranishëm, nëse marrim parasysh të gjitha shënimet në dispozicion, është më se e mundshme që obligimi i pranishëm ekziston më datën e pasqyrës së bilancit.

14. Pothuaj në të gjitha rastet do të jetë e qartë nëse ngjarja nga e kaluara e ka shtuar obligimin e pranishëm. Në rastet e rralla, për shembull në paditë gjyqësore, mund të ketë mosmarrëveshje se kur kanë ndodhur ngjarjet e caktuara ose nëse këto ngjarje rezultojnë me një obligim të pranishëm. Në një rast të atillë, ndërmarrja përcakton se kur ekziston obligimi i pranishëm më datën e pasqyrës së bilancit, duke i marrë parasysh të gjitha shënimet në dispozicion, duke e përfshirë, për shembull, mendimin e ekspertëve. Shënimet e konsideruara e përfshijnë çdo shënim shtesë të siguruar nga ngjarjet e ndodhura pas datës së pasqyrës së bilancit. Në bazë të të dhënave të tilla:
- (a) kur është më shumë e besueshme se sa jo, se obligimi i pranishëm ekziston më datën e pasqyrës së bilancit, ndërmarrja e njeh provizionin (nëse kriteri i njohjes plotësohet) dhe
  - (b) kur është më e besueshme se nuk ekziston ndonjë obligim i pranishëm më datën e pasqyrës së bilancit, ndërmarrja shpalos detyrimin kontingjent, vetëm nëse mundësia e një rrjedhe dalëse të burimeve të trupëzuara në përfitimet ekonomike është e dobët. Nëse mundësia është e dobët, shpalosja nuk kërkohet.

### **Ngjarja nga e kaluara**

15. Ngjarja nga e kaluara që nxit obligim të pranishëm quhet ngjarje obliguese. Që një ngjarje të jetë ngjarje obliguese, është e nevojshme që ndërmarrja të mos ketë alternativë reale për ta zgjidhur obligimin e krijuar nga ngjarja. Ky rast është vetëm:
- (a) kur pagesa e obligimit mund të imponohet me ligj, ose
  - (b) në rast të obligimit konstruktiv, ku ngjarja (që mund të jetë veprim i ndërmarrjes) krijon të pritura të vlefshme tek palët e tjera se ndërmarrja do ta shkarkojë obligimin.
16. Pasqyrat financiare kanë të bëjnë me pozitën financiare të ndërmarrjes në fund të periudhës raportuese dhe jo me pozitën e mundshme të saj në të ardhmen. Prandaj, asnjë provizion nuk njihet për humbjet operuese në të ardhmen. Obligimet e vetme që njihen në pasqyrën e bilancit të ndërmarrjes janë ato që ekzistojnë në datën e pasqyrës së bilancit.
17. Janë vetëm ato obligime që krijohen nga ngjarjet nga e kaluara që ekzistojnë pavarësisht nga veprimi i ardhshëm i ndërmarrjes (kryerja e biznesit në të ardhmen) që njihen si provizione. Shembuj të obligimeve të tilla janë gjokat ose kostot e spastrimit nga dëmtimet e paligjshme të rrethinës, ku të dyjat do ta krijojnë një rrjedhë dalëse të burimeve të

- trupëzuara në përfitimet ekonomike në përcaktim përfundimtar pavarësisht nga veprimet e ardhme të ndërmarrjes. Përndryshe, për shkak të presioneve komerciale ose kërkesave ligjore, ndërmarrja mund të dëshirojë ose të ketë nevojë që ta bëjë shpenzime për të vepruar në mënyrë të veçantë në të ardhmen (për shembull, duke i montuar filterat në lloje të caktuara të fabrikës për ta zvogëluar ndotjen e ajrit). Për arsye se ndërmarrja mund t'i shmangët shpenzimeve në të ardhmen, duke i ndryshuar veprimet e saj, për shembull, duke e ndryshuar metodën e saj të veprimit, ajo nuk do të ketë obligim të pranishëm për atë shpenzim në të ardhmen dhe nuk njihet asnjë provizion.
18. Ngjarja që nuk e shton një obligim menjëherë, mund ta bëjë atë më vonë, për arsye të ndryshimeve në ligj ose për shkak të veprimit (për shembull, pasqyra publike specifike e mjaftueshme) të ndërmarrjes për t'a shtuar obligimin konstruktiv. Për shembull, kur është shkaktuar dëmi në rrethinë mund të mos ketë asnjë obligim për t'i kompensuar pasojat. Megjithatë, shkaktari ose dëmi do të bëhet ngjarje obliguese, kur ligji i ri kërkon që dëmi ekzistues të korrigohet ose kur ndërmarrja publikisht merr përgjegjësi për korrigjimin në mënyrën që krijon një obligim konstruktiv.
19. Kur detajet e ligjit të ri të propozuar nuk janë finalizuar ende, obligimi rrjedh vetëm kur legjislati është praktikisht i caktuar për t'u miratuar siç është projektuar. Për qëllime të këtij standardi, obligimi i tillë trajtohet si obligim ligjor. Ndryshimet në kushtet që e rrethojnë dekretimin e pamundësojnë përcaktimin e një ngjarjeje të thjeshtë që do të mund ta bënte miratimin e ligjit praktikisht të sigurt. Në shumicën e rasteve do të jetë e pamundshme të jesh pothuajse i sigurt për miratimin e ligjit, derisa ai nuk miratohet.

### **Rrjedha dalëse e mundshme e burimeve të trupëzuara në përfitimet ekonomike**

20. Që një detyrim të cilësohet për t'u njohur nuk duhet të ekzistojë vetëm obligimi i pranishëm, por, po ashtu, mundësia e një rrjedhe dalëse e burimeve të trupëzuara në përfitimet ekonomike për ta përcaktuar përfundimisht atë obligim. Për qëllime të këtij standardi, një rrjedhë dalëse e burimeve ose një ngjarja konsiderohet e mundshme nëse ngjarja më shumë ka mundësi të ndodhë se sa të mos ndodhë (mundësia se ngjarja do të ndodhë është më e madhe se sa mundësia se nuk do të ndodhë). Kur nuk është e mundshme se ekziston obligimi i pranishëm, ndërmarrja e shpalos detyrimin kontingjent, vetëm nëse mundësia e rrjedhës dalëse të burimeve të përfshira në përfitimet ekonomike është e dobët. Nëse mundësia është e dobët, nuk kërkohet shpalosja.

### **Vlerësimi i besueshëm i obligimit**

21. Përdorimi i vlerësimeve është pjesë thelbësore e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe nuk e nënvlerëson besueshmërinë e tyre. Kjo është e vërtetë veçanërisht në rastin e provizioneve, të cilat për nga lloji i tyre janë shumë më të pasigurta se sa shumë zëra të tjerë në pasqyrqën e bilancit. Përveç në raste të rralla ekstreme, ndërmarrja do të jetë e aftë ta përcaktojë shkallën e rezultateve të mundshme dhe kështu që mund ta bëjë një vlerësim të obligimit që është mjaft i sigurtë për ta përdorur në njohjen e provizionit.
22. Në raste të rralla, ekstreme, kur nuk mund të bëhet një vlerësim i sigurt, obligimi ekzistues nuk mund të njihet. Ai detyrim shpaloset si detyrim kontingjent konform me kërkesat e shpalosjes.

### **Detyrimet kontingjente**

23. Ndërmarrja në pasqyrat financiare nuk duhet ta njohë detyrimin kontingjent.
24. Detyrimi kontingjent duhet të shpaloset, vetëm nëse mundësia e rrjedhës dalëse të burimeve të trupëzuara në përfitimet ekonomike është e dobët. Nëse mundësia është e dobët, nuk kërkohet shpalosja.
25. Detyrimet kontingjente mund të zhvillohen në një mënyrë që fillimisht nuk pritet. Prandaj, ato vlerësohen në vazhdimësi për të përcaktuar se kur dalja e burimeve të përfshira në përfitimet ekonomike do të kërkohet për një zë që më parë kishte të bënte me obligimin e papritur, provizioni njihet në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën ndodh ndryshimi në probabilitet.

### **Pasuria kontingjente**

26. Ndërmarrja nuk duhet ta njohë pasurinë kontingjente.
27. Pasuria kontingjente zakonisht rrjedh prej ngjarjeve të paplanifikuara ose ngjarjeve të tjera të papritura që e shtojnë mundësinë e një rrjedhe hyrëse të përfitimeve ekonomike në ndërmarrje. Një shembull është kërkesa që ndërmarrja është duke e ndjekur përmes procedurës ligjore, kur rezultati është i pasigurt.
28. Pasuritë kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare pasi që kjo mund të rezultojë me njohjen e të ardhurës e cila nuk do të mund të realizohej kurrë. Megjithatë, kur realizimi i të ardhurës është pothuajse i sigurtë, atëherë pasuria përkatëse nuk është pasuri kontingjente dhe është e duhur njohja e saj.



29. Pasuria kontingjente shpaloset, kur është e mundshme një rrjedhë hyrëse e përfitimeve ekonomike.
30. Pasuritë kontingjente vlerësohen vazhdimisht për të siguruar se zhvillimet janë reflektuar në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare. Nëse bëhet pothuajse e sigurt se do të krijohet një rrjedhë hyrëse e përfitimeve ekonomike, pasuria dhe e ardhura përkatëse njihen në pasqyrat financiare në periudhën në të cilën ndodh ngjarja. Nëse një rrjedhë hyrëse e përfitimeve ekonomike është bërë e kontingjente, ndërmarrja shpalos pasurinë kontingjente.

## **Matja**

### **Vlerësimi më i mirë**

31. Shuma e njohur si provizion duhet të jetë vlerësimi më i mirë i të dalave të kërkuara për ta përcaktuar përfundimisht obligimin e pranishëm më datën e pasqyrës së bilancit.
32. Vlerësimi më i mirë i të dalave të kërkuara për ta përcaktuar përfundimisht obligimin e pranishëm është shuma që ndërmarrja duhet ta paguajë në mënyrë të arsyeshme për ta përcaktuar përfundimisht obligimin e pranishëm në datën e pasqyrës së bilancit. Kjo do të jetë shpesh e pamundshme ose aq e shtrenjtë sa që do të jetë pengesë për ta përcaktuar përfundimisht ose për ta transferuar obligimin më datën e pasqyrës së bilancit. Megjithatë, vlerësimi i shumës që ndërmarrja duhet ta paguajë në mënyrë të arsyeshme për të përcaktuar përfundimisht obligimin, e jep vlerësimin më të mirë të së dalës së kërkuar për ta përcaktuar përfundimisht obligimin e pranishëm më datën e pasqyrës së bilancit.
33. Vlerësimi i rezultatit dhe efektit financiar përcaktohet nga gjykimi i menaxhmentit të ndërmarrjes, i plotësuar nga përvoja e transaksioneve të ngjashme dhe, në disa raste, raporteve të ekspertëve të pavarur. Të dhënat e konsideruara e përfshijnë çdo shënim shtesë të siguruar nga ngjarjet pas datës së pasqyrës së bilancit.
34. Pasiguritë që e rrethojnë shumën që duhet të njihet si provizion, shqyrtohen në mënyra të ndryshme sipas rrethanave. Një metodë për ta vlerësuar obligimin është matja e të gjitha rezultateve të mundshme nëpërmjet mundësive shoqëruese të tyre. Emri për këtë metodë statistikore të vlerësimit është “vlera e pritur”. Provizioni, si pasojë, do të jetë i ndryshëm varësisht nga fakti se sa është mundësia e humbjes së shumës së dhënë, për shembull 60 për qind ose 90 për qind. Kur ekziston një shkallë e vazhdueshme e rezultateve të kontingjente dhe ku secila

pikë në atë shkallë është e njejtë si edhe çdo pikë tjetër, përdoret pika e mesme e shkallës.

### Shembull

Një ndërmarrje shet mallra me garanci, nga e cila klientët mbulojnë shpenzimet e riparimit të çfarëdo defekti përpunues që paraqitet brenda gjashtë muajve pas blerjes. Nëse zbulohen defekte të vogla në të gjitha prodhimet e shitura, do të rezultojnë kostot e riparimit prej 10.000 DM. Nëse zbulohen defekte të mëdha në të gjitha prodhimet e shitura, do të rezultojnë kostot e riparimit prej 40.000 DM. Përvoja nga e kaluara dhe pritjet për të ardhmen të ndërmarrjes tregojnë se për vitin e ardhshëm 75 përqind e mallrave të shitura nuk do të kenë defekte, 20 përqind e mallrave të shitura do të kenë defekte të vogla dhe 5 përqind e mallrave të shitura do të kenë defekte të mëdha. Në mënyrë që të llogaritet “vlerën e pritur” të defekteve, ndërmarrja e vlerëson mundësinë e një rrjedhe dalëse të obligimeve të garantuara si tërësi.

Vlera e pritur e kostove të riparimit është:

$$(75\% \text{ e } 0) + (20\% \text{ e } 10.000) + (5\% \text{ e } 40.000) = 4.000 \text{ DM}$$

35. Pasi të jetë bërë matja e obligimit të vetëm, rezultati më i besueshëm individual mund të jetë vlerësimi më i mirë i detyrimit. Megjithatë, madje edhe në një rast të tillë, ndërmarrja merr parasysh rezultatet e tjera të mundshme. Kur rezultatet e tjera në shumë raste janë më të larta ose më të ulëta se sa rezultati i mundshëm, vlerësimi më i mirë do të jetë shuma më e lartë ose më e ulët. Për shembull, nëse ndërmarrja ka për ta korrigjuar një gabim serioz në fabrikën kryesore që është konstruktuar për klientët, rezultati individual më i mirë mund të jetë që riparimi të arrijë sukses në përpjekjen e parë me kosto prej 5.000 DM, por provizioni për shuma më të mëdha bëhet nëse ekziston gjasë e madhe që përpjekjet e mëtejme do të jenë të nevojshme.
36. Provizioni matet para tatimit, si pasojat e tatimore nga provizionit dhe ndryshimi në të, me të cilat merret SKK 12 “Tatimi mbi fitimin”.

### Rreziqet dhe pasiguritë

37. Rreziqet dhe pasiguritë të cilat në mënyrë të paevitueshme rrethojnë shumë ngjarje dhe kushte, duhet të merren parasysh për arritjen e vlerësimit më të mirë të provizionit.
38. Rreziku e paraqet ndryshueshmërinë e rezultatit. Korrigjimi i rrezikut mund ta shtojë shumën në të cilën është matur obligimi. Nevojitet kujdes gjatë gjykimin të kushteve të pasigurisë, kështu që e ardhura ose pasuria të mos mbivlerësohet dhe shpenzimet ose obligimet të mos nënvlerësohen. Prandaj, pasiguria nuk e arsyeton krijimin e provizioneve të tepërta ose mbivlerësimin e kujdesshëm të obligimeve. Për shembull, nëse kostot e projektuara të rezultatit të pafavorshëm e të veçantë vlerësohen mbi baza të matura, ai rezultat atëherë nuk është trajtuar me qëllim si më i mundshëm se sa është rasti realisht. Kujdesi nevojitet për t'iu shmangur korrigjimit të dyfishtë për rrezikun dhe pasigurinë me pasojën e zmadhimit të provizionit.
39. Kërkohet shpalosja e pasigurive që e rrethojnë shumën e të dalës.

### **Vlera e pranishme**

40. Kur efekti i vlerës kohore të parasë është material (kur efekti i provizionit është shtrirja gjatë disa viteve në të ardhmen), shuma e provizionit duhet të jetë vlera pranishme e të dalave që pritet të kërkoen për ta përcaktuar obligimin përfundimisht.
41. Shkalla e zbritjes e përdorur për ta llogaritur vlerën pranishme duhet të jetë shkallë para-tatimore që i reflekton vlerësimet e pranishme të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit.

### **Ngjarjet e ardhshme**

42. Ngjarjet e ardhshme që mund të ndikojnë në shumën e kërkuar për ta përcaktuar përfundimisht obligimin, duhet të pasqyrohen në shumën e provizionit, kur ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme objektive se ato do të ndodhin.

### **Tjetërsimet e pritura të pasurisë**

43. Përfitimet nga tjetërsimet e pritura të pasurisë nuk duhet të merren parasysh gjatë matjes së provizionit.
44. Përfitimet nga tjetërsimet e pritura të pasurisë nuk merren parasysh gjatë matjes së provizionit, madje edhe nëse tjetërsimi i pritur lidhet ngushtë me ngjarjen duke i dhënë rritje provizionit. Në vend të kësaj, ndërmarrja i një fitimit nga tjetërsimet e pritura të pasurisë në kohën e caktuar me

standardet e kontabilitetit të Kosovës, duke u marrë me pasuritë përkatëse.

### **Kompensimet**

45. Kur disa të dala ose të gjitha të dalat që kërkohen për ta përcaktuar përfundimisht provizionin pritet të kompensohen nga pala tjetër, kompensimi duhet të njihet atëherë dhe vetëm atëherë, kur është praktikisht e sigurtë se kompensimi do të pranohet, nëse ndërmarrja përcakton përfundimisht obligimin. Kompensimi duhet të trajtohet si pasuri e veçantë. Shuma e njohur për kompensim nuk duhet ta tejkalojë shumën e provizionit.
46. Në pasqyrën e të ardhurave, shpenzimi lidhur me provizionin mund të pasqyrohet neto nga shuma e njohur për kompensim.

### **Ndryshimet në provizione**

47. Provizionet duhet të përdoren vetëm për të dalat, për të cilat provizioni njihet që nga fillimi.
48. Vetëm të dalat që lidhen me provizionet fillestare vendosen kundrejt tij. Vendosja e të dalave kundrejt provizionit që ishte njohur fillimisht për ndonjë qëllim tjetër do ta shlyente efektin e dy ngjarjeve të ndryshme.

### **Aplikimi i njohjes dhe rregullat e matjes**

#### **Humbjet e veprimit në të ardhmen**

49. Provizionet nuk duhet të njihen për humbjet e veprimit në të ardhmen. Humbjet e operimit në të ardhmen nuk e përmbushin përkufizimin e obligimit dhe kriteri i përgjithshëm i njohjes vendoset jashtë provizioneve.
50. Pritja e humbjes së veprimit në të ardhmen tregon se pasuria e caktuar e operimit mund të riparohet. Ndërmarrja i teston këto pasuri për riparim sipas SKK 3 “Pasuritë e patundshme, impiantet dhe pajisjet”.

#### **Kontratat e vështira**

51. Nëse ndërmarrja ka kontratë që është e vështirë, obligimi pranishëm sipas kontratës duhet të njihet dhe të matet si provizion.
52. Shumë kontrata mund të anulohen pa pagesën e kompensimit ndaj palës tjetër pa asnjë obligim. Kontratat e tjera vendosin si për të drejtat, ashtu edhe për obligimet për secilën nga palët kontraktuese. Kur ngjarjet e bëjnë kontratën e tillë të vështirë, kontrata hyn brenda fushëveprimit të

këtij standardi dhe ekziston detyrimi, i cili duhet të njihet. Kontratat zbatuese që nuk janë të vështira mbeten jashtë fushëveprimit të këtij standardi.

53. Ky standard kontratën e vështirë e përkufizon si kontratë në të cilën kostoja e pashmangshme për plotësimin e obligimeve sipas kontratës i tejkalon përfitimet ekonomike që pritet të pranohen sipas tij. Kostot e pashmangshme sipas kontratës llogariten si shuma më të ulta të:
- (a) kostos së përmbushjes së kontratës; dhe
  - (b) çfarëdo shumash për t'u paguar ose gjordat që krijohen nga dështimi për t'i plotësuar ato.
54. Para se të vendoset provizioni i ndarë për kontratën e vështirë, ndërmarrja njihet çfarëdo humbje nga dëmtimi që ka ndodhur në pasuri që i dedikohet asaj kontrate (shih SKK 3 "Patundshmëritë, impiantet dhe pajisjet").

### **Shpalosja**

55. Për çdo lloj provizioni, ndërmarrja duhet të shpalosë:
- (a) shumën e regjistruar në fillim dhe në fund të periudhës
  - (b) provizionet shtesë të bëra gjatë periudhës, duke e përfshirë rritjen në provizionet ekzistuese
  - (c) shumat e përdorura (të ndodhura dhe të ngarkuara kundrejt provizionit) gjatë periudhës; dhe
  - (d) shumat e papërdorura, të kthyera gjatë periudhës. Informata krahasuese nuk kërkohet.
56. Për çdo lloj të provizionit ndërmarrja duhet ta shpalosë në vazhdim:
- (a) përshkrimin e shkurtër të natyrës së obligimit dhe kohëzgjatjen e pritur të çfarëdo rezultimi të rrjedhave dalëse të përfitimeve ekonomike
  - (b) treguesin e pasigurive rreth shumës ose kohëzgjatjes së këtyre rrjedhave dalëse. Kur nevojitet sigurimi i informatës adekuate, ndërmarrja duhet t'i shpalosë supozimet kryesore të bëra lidhur me ngjarjet e ardhshme; dhe
  - (c) shumën e kompensimit të pritur, duke e dhënë shumën e çfarëdo pasurie që ka qenë njohur për atë kompensim të pritur.

57. Përveç nëse mundësia e ndonjë rrjedhe dalëse në procesin e përcaktimit përfundimtar është paksa e mundshme, ndërmarrja duhet të shpalosë çdo lloj të detyrimit kontingjent në datën e pasqyrës së bilancit, një përshkrim të shkurtër të natyrës së detyrimit dhe, ku praktikohet:

- (a) një vlerësim të efektit të tij financiar
- (b) një tregues të pasigurive lidhur me shumën ose afatin e çdo rrjedhe dalëse; dhe
- (c) mundësia e çdo kompensimi.

Nëse nuk është e praktikohet shpalosja e informatës, ky fakt duhet të theksohet.

58. Kur provizioni dhe detyrimi kontingjent rrjedhin nga rrethanat e njejta, ndërmarrja e bën shpalosjen në mënyrën që e tregon lidhjen midis provizionit dhe detyrimit kontingjent.

59. Kur rrjedha hyrëse e përfitimeve ekonomike është e kontingjente, ndërmarrja duhet ta shpalosë një përshkrim të shkurtër të natyrës së pasurive kontingjente në pasqyrën e bilancit, dhe ku është e praktikueshme, një vlerësim të efektit financiar të tyre. Nëse nuk është e praktikueshme për ta shpalosur informatën, ai fakt duhet të theksohet.

60. Është me rëndësi që shpalosjet për pasuritë kontingjente t'i shmangen shfaqjes së treguesve çorientues se ka gjasa që të dalin të ardhura nga kontingjentet.

61. Në rastet jashtëzakonisht të rralla, shpalosja e disa ose të gjitha informatave që kërkohen nga vlera 56-59 mund të krijoj një paragjykim serioz të pozitës së ndërmarrjes në mosmarrëveshje me palët tjera rreth çështjeve të provizionit, detyrimit kontingjent ose pasurisë kontingjente. Në raste të tilla, ndërmarrja nuk duhet ta shpalosë informatën, por duhet ta shpalosë natyrën e përgjithshme të mosmarrëveshjes, së bashku me faktin dhe arsyen pse informata nuk ka qenë shpalosur.

### **Provizionet kalimtare**

62. Efekti i pranimit të këtij standardi në datën e hyrjes në fuqi duhet të raportohet si një korrigjim i bilancit fillestar të fitimit të mbajtur për periudhën, gjatë të cilës standardi është pranuar së pari. Ndërmarrjet përkrahen, por nuk kërkohet që ta korrigjojnë bilancin fillestar të fitimit të mbajtur për periudhat e mëhershme të paraqitura dhe që ta rishpallin

informatë krahasuese. Nëse informata krahasuese nuk rishpallet, ky fakt duhet të shpaloset.

63. Ky standard kërkon trajtim të ndryshëm nga SKK 5 “Fitimi ose humbja neto për periudhë, zërat e jashtëzakonshëm, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet fundamentale”. SKK 5 kërkon që ndryshimi në politikën kontabël të aplikohet në të ardhmen, pa harmonizim të bilancit fillestar të fitimit të mbajtur. Prandaj, si thuhet në SKK 5, ndryshimi në politikë që është bërë në pranimin e standardit të kontabilitetit në Kosovë, duhet të përlllogaritet konform me provizionet specifike kalimtare në atë SKK.

### Data e hyrjes në fuqi

64. Ky standard është i plotëfuqishëm për pasqyrat financiare prej ose pas 1 janar 2002. Përkrahët përdorimi i mëhershëm.

### SHTOJCA

Qëllimi i kësaj shtojce është të përmbledhë dhe të japë shembuj të kërkesave kryesore të standardit. Kjo nuk formon pjesën e standardit dhe duhet të lexohet në kontekst të tekstit të plotë të standardit.

### PROVIZIONET DHE DETYRIMET KONTINGJENTE

Kur, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, mund të ketë rrjedha dalëse të burimeve të trupëzura në përfitimet e ardhshme ekonomike në zgjidhjen e: (a) obligimit të pranishëm; ose (b) obligimit të mundshëm, ekzistenca e të cilit do të vërtetohet vetëm me ndodhjen ose mosndodhjen e një ose më tepër ngjarjeve të pasigurta në të ardhmen jo tërësisht brenda kontrollit të ndërmarrjes		
Ekziston obligimi i pranishëm që me gjasë kërkon rrjedhë dalëse të burimeve	Ekziston obligim i mundshëm ose obligim ushtrimor që mund, por me gjasë nuk do të kërkojë rrjedhë dalëse të burimeve	Ekziston obligim i mundshëm ose obligim ushtrimor, me ç'rast gjasa e daljes së burimeve është i dobët
Provizioni njihet	Asnjë provizion nuk njihet	Asnjë provizion nuk njihet
Shpalosjet kerkohen per provizionet	Shpalosjet kerkohen për detyrimin kontingjent.	Nuk kerkohet shpalosja

Rrjedha hyrëse e përfitimeve ekonomike praktikisht është e sigurtë Rrjedha hyrëse e përfitimeve ekonomike është e kontingjente, por praktikisht nuk është e sigurtë Rrjedha hyrëse nuk është e besueshme Pasuria nuk është kontingjente.

Pasuria nuk njihet. Shpalosjet kërkohen. Pasuria nuk njihet. Shpalosja nuk kërkohet.

### **SHEMBUJT**

Në të gjitha rastet, supozohet se mund të bëhet një vlerësim i besueshëm për çdo rrjedhë dalëse të pritur.

#### **Shembulli i parë: Kontrata e vështirë**

Ndërmarrja punon me përfitim nga fabrika që është marrë në lizing sipas lizingut veprues. Gjatë dhjetorit 2002 ndërmarrja i zhvendos punët e saj në një fabrikë të re. Lizingu në fabrikën e vjetër vazhdon për dy vitet e ardhshme, ajo nuk mund të anulohet dhe fabrika nuk mund t'i lejohet ndonjë përdoruesi tjetër.

**Obligimi i pranishëm si rezultat i pjesës së ngjarjes obliguese** - Ngjarja obliguese është nënshkrimi i kontratës së lizingut për fabrikën e vjetër, e cila e krijon obligimin ligjor.

**Një rrjedhë dalëse e burimeve të trupëzuara në përfitimet ekonomike në zgjidhje** - Kur lizingu bëhet i vështirë, dalja e burimeve, përfshirë përfitimet ekonomike, është e besueshme. (Përveq nëse lizingu bëhet i vështirë, ndërmarrja llogarit lizingun sipas SKK 13 "Lizingët")

**Përfundim** - Provizioni njihet për vlerësimin më të mirë të pagesave të pashmangshme të lizingut.

#### **Shembulli i dytë: Rasti gjyqësor**

Pas martesës më 2002, dhjetë njerëz kanë vdekur, me gjasë si rezultat i helmimit me ushqim nga prodhimet e shitura nga ndërmarrja. Procedurat ligjore filluan t'i kërkonin dëmet nga ndërmarrja, por ajo e kundërshtonte detyrimin. Deri më datën e autorizimit për nxjerrje të pasqyrave financiare për vitin 2002, avokatët e ndërmarrjes këshilluan se është e kontingjente që ndërmarrja të mosjetë përgjegjëse. Mirëpo, kur ndërmarrja i përgatiti pasqyrat financiare për vitin 2003, rasti ende nuk është zgjidhur përfundimisht dhe avokatët e saj e këshillojnë që, si pasojë nga zhvillimet e rastit, është e besueshme që ndërmarrja do të jetë përgjegjëse.

Për pasqyrat financiare të datës 31 dhjetor 2002:

**Obligimi ushtrimor si rezultat i ngjarjes obliguese në të kaluarën** - Në bazë të dhënave në dispozicion, kur pasqyrat financiare aprovohen, nuk ekziston obligimi si rezultat i ngjarjeve nga e kaluara.

**Përfundim** - Nuk njihet provizioni. Çështja shpaloset si detyrim kontingjent, përveç nëse gjasat e ndonjë rrjedhë dalëse mendohet të jenë paksa të dobëta.

Për pasqyrat financiare të datës 31 dhjetor 2003:



**Obligimi ushtrimor si rezultat i ngjarjes obliguese nga e kaluara** - Mbi bazën e të dhënave në dispozicion, obligimi i pranishëm ekziston.

**Dalja e burimeve përfshirë përfitimet ekonomike në zgjidhje** - e mundshme.

**Përfundim** - Provizioni njihet për vlerësimin më të mirë të shumës për ta përcaktuar obligimin përfundimisht.

**Shembulli i tretë: Rinovimi**

Disa pasuri kërkojnë, përveç mirëmbajtjes rutinore, shpenzim substancial për disa vjet për rinovimin dhe zëvendësimin e komponenteve kryesore. SKK 3 “Patundshmëritë, impiantet dhe pajisjet”, jep udhëzimin mbi alokimin e të dalave në një pasuri për pjesët përbërëse të tij, me ç’rast këto komponente kanë jetë të ndryshme të përdorimit ose sigurojnë përfitime në struktura të ndryshme.

Furra e shkrites e ka linjën që duhet të zëvendësohet çdo pesë vjet për arsye teknike. Në datën e pasqyrës së bilancit, linja ka qenë në përdorim për tre vjet.

**Obligimi ushtrimor si rezultat i ngjarjes obliguese nga e kaluara** - Nuk ekziston obligim ushtrimor.

**Përfundim** - Nuk njihet provizioni.

Kostoja e zëvendësimit të linjës nuk njihet sepse, më datën e pasqyrës së bilancit, nuk ka obligim për ta zëvendësuar linjën ekzistuese, pavarësisht nga veprimet e ardhshme të kompanisë. Madje edhe synimi që të dalat të ndodhin, varet nga kompania se a ka vendosur që ta vazhdojë punën e furrës ose ta zëvendësojë linjën. Në vend të njohjes së provizionit, amortizimi i linjës e merr parasysh jetën ekonomike të tij (zhvlerësohet për pesë vjet). Kostot e rinovimit të linjës kapitalizohen kur të kenë ndodhur dhe amortizohen gjatë pesë viteve të ardhshme.